



*Empowered lives.
Resilient nations.*

**NDËRMARRJA E VEPRIMEVE TË PËRBASHKËTA:
MENAXHIMI I MBETJEVE INDUSTRIALE TË
NDËRMARRJES TREPÇA**

Raporti i konferencës ndërkombëtare

Mitrovicë, 19–20 shtator 2011

Përkthyesit

Shqip: Besim Kokollari

Sërbisht: Besmir Fidahic

Dizajni: www.xhad.net

Shtypi:

Pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk i shprehin domosdoshmërisht pikëpamjet e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

PËRMBAJTJA

INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME.....	4
Përmbledhje e sesionit.....	5
TEMA 1: Gjendja e mjedisit në rajonin e Mitrovicës.....	7
E kaluara, e tanishmja dhe e ardhmja e Trepçës.....	7
Një vështrim i përgjithshëm i gjendjes aktuale të deponive të Trepçës dhe ndikimi i tyre në mjedis.....	8
Strategjia minerare e Kosovës dhe politikat mjedisore.....	8
Cilësia e mjedisit në rajonin e Mitrovicës pas eksploatimit në shkallë të gjerë të mineraleve nga Ndërmarrja Trepça.....	8
Gjendja e mjedisit në pikat e nxehta.....	9
Deponitë e Trepçës dhe minierat e Trepçës – problemet mjedisore – një përmbledhje e zgjidhjeve.....	10
Trajtimi i pikave të nxehta (përvoja) dhe gjendja e mjedisit në parkun industrial të Mitrovicës.....	10
TEMA 2: Aktivitetet minerare / metalurgjike të Trepçës dhe ndikimi i tyre në shëndetin e njerëzve.....	11
Ndikimi i kontaminimit të mjedisit me plumb për shëndetin e njeriut në rajonin e Mitrovicës.....	11
Bujqësia urbane dhe në periferi si rrugë për thithjes së ndotësve të rëndë të metalit nga njeriu.....	11
Tema 3: Strategjitë lehtësuese – praktikat më të mira ndërkombëtare për përmirësimin dhe zhvillimin ekonomik.....	13
Rreziqet e vazhdueshme nga deponitë e mbetjeve, rrugët kryesore të kontaminimit, masat e nevojshme për zvogëlimin e rrezikut.....	13
Aktivitete përmirësuese në 8 lokacione të nxehta në Ballkanin perëndimor.....	14
Iniciativat e ENVSEC në lidhje me menaxhimin e mbetjeve industriale.....	14
Koncepti i përmirësimit të deponive në Evropën juglindore, shembuj nga Kosova, Serbia, Mali i Zi, Rumania dhe Gjermania.....	14
Lista e prioriteteve në fushën e rikultivimit të zonave të kontaminuara dhe të menaxhimit të mbetjeve industriale të Ndërmarrjes së minierës Trepça.....	15
Intervenimet në lokacionet minerare nga UNDP/UNEP në Ballkanin Perëndimor.....	16
Përmbledhje e konferencës.....	18
Përmbledhje e rekomandimeve nga Konferenca për Menaxhimin e Mbetjeve Industriale të Ndërmarrjes Trepça -.....	18
Objektivat e konferencës.....	18
Plotësimi i kornizës ligjore në sektorin e minierave.....	19
Kontaminimi historik dhe veprimtaria aktuale e Trepçës.....	19
Harmonizimi i të dhënave ekzistuese lidhur me mbetjet industriale.....	19
Promovimi i konceptit për zhvillim të qëndrueshëm.....	20
Plani i veprimit dhe prioritizimi i intervenimeve në lokacionet e mbetjeve industriale.....	20
Propozimet për aktivitetet e pastrimit të dhëna gjatë konferencës për menaxhimin e mbetjeve industriale të Ndërmarrjes Trepça.....	20
I. INTERVENIMET E MENJËHERSHME.....	20
II. Masat përmirësuese afatshkurtra dhe afatgjata.....	23
III. REHABILITIMI I TOKËS BUJQËSORE.....	26
IV. Fushatat e vetëdijesimit.....	27
ANEKSI 1 – AGJENDA.....	28
ANEKSI 2 – LISTA E PJESËMARRËSVE.....	31

INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Ndërmarrja e Trepçës ishte shtylla e ekonomisë së Kosovës, dhe se miniera ishte industria kryesore e Kosovës. Në kulmin e veprimtarisë së saj në vitet e 80-ta të shekullit të kaluar, Trepça ofronte punë për 22,500 punëtorë dhe kishte një qarkullim mesatar vjetor prej 100 milion dollarë amerikan. Sot, ku shumica e impianteve janë të mbylura dhe me një eksploatim të kufizuar të mineraleve, ndërmarrja e Trepçës paraqet potencialin më të madh të Kosovës për ripërtëritje ekonomike dhe, në të njëjtën kohë, paraqet sfida të mëdha karshi mjedisit dhe varfërisë.

Veprimtarisë qendrore e mëhershme e Trepçës në pjesën veriore dhe lindore të Kosovës përcillet me një trashëgimi të rënduar të mbetjeve toksike që i rrezikojnë mijëra burra, gra e fëmijë. Llumi acidik, emetimi i pluhurit, punët e pasiguruara, deponitë e paqëndrueshme dhe që nuk janë mirëmbajtur mirë përbëjnë rrezik të përditshëm për ata që jetojnë afër tyre. Në zonat më të kontaminuara, ujërat lokale janë të ndotura, tokat e punueshme shpërhapin helme të metaleve të rënda në ushqimet jetësore dhe se ajri është i ndotur me pluhur që i shkakton dëme mushkërive. Komuna e Mitrovicës dhe e Zveçanit janë ndër zonat më të prekura. Një anketë e OBSH-së për fëmijët nën tre vjeç në Mitrovicë dhe Zveçan tregoi që së paku një çerek i tyre kishin nivel të theksuar të plumbit në gjak (që shkonte në 100 për qind të fëmijëve të anketuar të bashkësisë RAE). Megjithatë, problemi është edhe më i përhapur, si në Leposaviq në veri dhe në Artanë dhe Hajvali në lindje.

Në të njëjtën kohë, ndërmarrja Trepça është një mundësi jetësore për disa prej pjesëve më të varfra dhe më të pazhvilluara të Kosovës në aspektin ekonomik. Shkalla mesatare e varfërisë në Kosovë është më e larta në Evropë, ku gati gjysma (46 për qind) e popullsisë jetojnë me më pak se 43 euro në muaj dhe gati se një e pesta e popullsisë jeton në varfëri të skajshme. Vlerësohet se më shumë se një në dhjetë banorët që jetojnë në Mitrovicë nuk mund t'i përmbush nevojat e tij kryesore.

Duke i pasur parasysh këto të dhëna sfiduese, atëherë pasurit e përfaqësuara nga Trepça janë domethënëse për të ardhmen e Kosovës. Mundësia për të nxjerrë burime të pasura minerare, si dhe linjiti i bollshëm në Kosovë për prodhimin e energjisë mund të shërbenin si katalizator të rëndësishëm për rritje dhe për t'u dhënë mundësi dhjetëra e mijëra njerëzve. Përveç kësaj, veprimet e konsoliduara për t'i mbajtur nën kontroll këto mbetje industriale mund të krijojnë vetvetiu vende të reja pune, t'i rivitalizojnë bashkësitë, si dhe do ta dëshmonin një gjeneratë të tërë të rinjve të cilët janë të gatshëm për punë.



Andaj, është e nevojshme dhe urgjente që të trajtohen si çështjet komplekse, ashtu edhe ato që kanë të bëjnë me Trepçën. E ardhmja e ekonomisë së Kosovës si dhe shëndeti social do të mundësojnë që të përqendrohemi kryesisht në një strategji – e cila sipas përkufizimit duhet t'i trajtojë disa prej kushteve më të këqija shëndetësore dhe të përgjithshme në Evropë, liria e kapitalit njerëzor, krijimi i vendeve të punës dhe bruto produkti vendor (BPV) dhe të zhbërjes së trashëgimisë së hidhur e të padrejtësisë sociale.

Përmbledhje e sesionit

Dita e parë – 10 shtator 2011

Sesioni i hapjes

Konferenca për menaxhimin e mbetjeve industriale për Ndërmarrjen Trepça u hap nga zëvendës kryeministri z. Bujar Bukoshi, nga zëvendësministri për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, z. Ilir Mirena, nga zëvendësministri për Zhvillim Ekonomik, z. Gani Koci, nga menaxheri i përgjithshëm i Trepçës, z. Ferat Shala dhe nga koordinatori i OKB-së dhe përfaqësuesi lokal i UNDPT-së në Kosovë, znj. Osnat Lubrani.

Z. Bujar Bukoshi u dëshiroi mirëseardhje të pranishmëve në konferencë. Ai ua përkujtoi se ndërmarrja Trepça ishte një prej vendeve më të rëndësishme industriale dhe punëdhënësi më i madh në Kosovë; megjithatë, është edhe një burim i madh i ndotjes. Ai e pohonte faktin se duhet të bëhen më shumë përpjekje për mbrojtjen e mjedisit dhe përfundoi se është e nevojshme të kihet një plan i veprimit për bashkërendimin e aktiviteteve mes palëve të ndryshme të interesit për trajtimin e kontaminimit që rezultojnë nga Trepça, si dhe u pajtua në disa masa lehtësuese që duhet ndërmarrë në aspektin afat shkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë.

Znj. Osnat Lubrani në fjalën e saj tha se jemi të përkushtuar që ta ndihmojmë

Kosovë për ta përsheptuar zhvillimin e saj në harmoni me aspiratat që ka për Evropë. E dëgjojmë shpesh nevojën për rritje të ekonomisë përmes zhvillimit të sektorit privat ose krijimit të mjediseve më të mira në aspektin rregullues me qëllim që të tërhiqen investitorët e huaj, me qëllim që të krijohen vende pune, veçanërisht të për të rinjtë e Kosovës. Agjencia për Zhvillim e OKB-së në Kosovë (UNKT) e bashkë-ndanë këtë vizion, porse theksojmë se: Kosova nuk ka nevojë për çfarëdo zhvillimi. Ajo që keni nevojë për zhvillim është që të jetë i qëndrueshëm. Zhvillimi i qëndrueshëm ka të bëjë me qeniet njerëzor, shëndetin e tyre, të drejtën për të gëzuar barazi, dhe që mos të lihen anash. Ajo e përmendi se koncepti “të rritet më së pari ekonomia, dhe pastaj të pastrohet

*Foto 1.
Hapja e konferencës
(nga e djathta në të
majtë): z. Ilir Mirena,
z. Bujar Bukoshi, znj.
Osnat Lubrani, z.
Gani Koci
dhe z. Ferat Shala*



më vonë” nuk është një opsion i mundshëm për cilindo vend – pa marrë parasysh të zhvilluar apo nën zhvillim.

Qytetet, si Mitrovica, me një zhvillim industrial dhe trashëgimi të ndotjes, përballen me sfida komplekse. Në të kaluarën, lokacionet e minierave metalurgjike ofronin mundësi të mira ekonomike si dhe vende të shumta pune. Prapë se prapë, kjo është bërë në dëm të mjedisit dhe të shëndetit të njerëzve, duke i goditur më së shumti të varfrit dhe të ekspozuarit, të cilët nuk i kishin mundësitë e zhvendosjes në hapësira më pak të ndotura. Në konferencë, duhet t'i kemi parasysh zgjidhjet e menjëhershme dhe afatmesme, por pa e neglizhuar edhe perspektivën afatgjatë.

Duhet të reflektojmë në një strategji të integruar të zhvillimit lokal për rajonin e Mitrovicës, e cila mund ta orientojë potencialin ekonomik të këtij rajoni pa e sakrifikuar qëndrueshmërinë afatgjatë. Prania e ekspertëve lokal në këtë konferencë, pastaj e ekspertëve nga Evropa, dhe të ekspertëve nga agjencitë e OKB-së, na jep mundësinë që të gjejmë zgjidhje ndërsektoriale të cilat janë funksionale. Me siguri se çdo zgjidhje duhet të bazohet në njohuritë vendore të bashkësive, mendimet e të cilëve do të na ndihmonin që të dalim me strategjitë më të mira se si ta mbështesim pastrimin hap pas hapi të ajrit të ndotur, që të investojmë në teknologji më të pastra për ta zvogëluar kontaminimin e ujit dhe tokës si dhe të ndotjes së ajrit, e po ashtu edhe të sigurohet një integrim më i fuqishëm i shqetësimeve mjedisore në politikat sektoriale, duke përfshirë edhe bashkëpunimin gjithëpërfshirës.

Shumë vende frikësohet se “qëndrueshmëria” nënkupton “kosto të lartë”, por a janë brengat e tilla me vlerë? Qëndrueshmëria mund të nënkuptojë edhe konkur-

rencë të zgjeruar; mund të nënkuptojë krijimi i një modeli më të mirë të zhvillimit që e merr parasysh shëndetin e qytetarëve, ajrin të cilin e thithin, ujin, motin, si dhe mundësitë ekonomike kombëtare. Mund të nënkuptojë edhe kursim.

Në përmbyllje të fjalës, znj. Lubrani tha se objektivat e konferencës janë ambicioze, porse të arritshme dhe e shprehi besimin e saj se do të dalin prioritetet konkrete, të cilat mund të shërbejnë për orientimin e të gjitha palëve të interesit. Në pjesën e vet, UNDP-ja dhe UNKT-ja janë të interesuara të kontribuojnë në projekte të menjëhershme dhe afatgjatë.

Z. Ilir Mirena i përshëndeti pjesëmarrësit dhe tha se konferenca ofron një mundësi të mirë për të dalë me ide dhe sugjerime kreative dhe inovative me qëllim të gjetjes së zgjidhjeve për menaxhimin si duhet të mbetjetve industriale që shkaktohen nga ndërmarrja Trepça.

Z. Gani Koci tha se Kosova ka një potencial të madh në fushën e mineraleve, dhe se pasuritë minerare luajnë një rol kyç në zhvillimin e vendit. Qeveria e Kosovës e ka identifikuar sektorin minerar si shtyllën kryesore për ringjalljen dhe zhvillimin ekonomik. Për shkak të shfrytëzimit të keq të pasurive minerare në të kaluarën, Kosova tani përballlet me sfida të mëdha mjedisore të cilat ndikojnë në shëndetin e njeriut. Ministria e Zhvillimit Ekonomik është në fazën e fundit të hartimit të Strategjisë Minerare të Kosovës.

Z. Ferat Shala pohoi se kjo konferencë është një mundësi speciale që e kthen vëmendjen, edhe njëherë, tek sfidat mjedisore të cilat i ka trashëguar Trepça nga e kaluara, si dhe nevojën për trajtimin e duhur të problemeve mjedisore në të ardhmen.

TEMA 1:

Gjendja e mjedisit në rajonin e Mitrovicës E kaluara, e tanishmja dhe e ardhmja e Trepçës

Z. Ferat Shala, menaxher i përgjithshëm i Ndërmarrjat Trepça, e dha një pasqyrë të përgjithshme të gjendjes në të kaluarën dhe në të tashmen të Trepçës. Ai e theksoi se Trepça ishte punëdhënësi më i madh i Kosovës në të kaluarën, duke punësuar rreth 20,000 njerëz, si dhe ishte ndërmarrjadhe eksportuesi më i madh në Kosovë.

Aktualisht, Trepça është në menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit – i ka të punësuar 2,348 punëtorë, prej të cilëve 1,439 në Mitrovicën Jugore dhe 297 në Mitrovicën Veriore. Nxjerrja e mineraleve është rritur që prej vitit 2005 kur Trepça i rifilloi punimet, si në tabelën më poshtë. Ndërmarrja Trepça është duke u konsoliduar dhe duke u bërë financiarisht e qëndrueshme falë rritjes së çmimeve të metalit/ stabilizimi i tregut global. Megjithatë, z. Shala theksoi, po ashtu, se mbesin shumë gjera për t'u përmirësuar sa i përket efikasiteti të stafit, si dhe investimet në teknologji të përpunimit që janë miqësore ndaj mjedisit

Viti	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011 (sipas datës 1 qershor)
Sasia e minerarit të nxjerrë (1)	22 027	57 531	58 963	90 817	119 754	128 054	105 599

Z. Shala tha se kërcënimi më i madh për mjedisin dhe shëndetin e njerëzve përbëjnë tash për tash mbetjet e mbledhura me kohë që janë krijuar dhe deponuar afër minierave të mëhershme, prej të cilave dallohen:

Emri i deponisë	Vendi	Statuti i deponisë	Hapësira e mbuluar (ha)	Sasia e mbetjeve (t)
Gornji Kmjin	Leposaviq	E braktisur	6.5	2 600 000
Bostaniste	Leposaviq	Aktive	8 - 10	3 600 000
Zhitkovac	Zveçan	E braktisur	26	8 500 000
Gornje Polje	Zveçan	E braktisur	50	12 000 000
Gornje Polje	Zveçan	Llum plumbi – e braktisur	4 - 6	2 500 000
Zveçan	Zveçan	Pluhur – e braktisur	10 – 15	10 000 000
Kelmend	Kelmend	Aktive	8 - 10	3 600 000
Parku industrial i Mitrovicës	Mitrovicë	E braktisur	35	4 200 000
Staro Jalovishte	Graçanicë	E braktisur	40	11 000 000
Badovc	Badovc	Aktive	18	7 700 000
Artanë	Artanë	E braktisur	4	1 800 000
		Total	209.5 -220.5	67 500 000

Në fund të prezantimit të tij, z. Shala theksoi se kontaminimi i kamotshëm dhe veprimtaria aktuale e Trepçës do të trajtohen si dy gjëra të ndara dhe se kontaminimi i trashëguar nuk do të jetë barrë për ristrukturimin e të ardhmes së Trepçës ose për procesin e privatizimit.

Një vështrim i përgjithshëm i gjendjes aktuale të deponive të Trepçës dhe ndikimi i tyre në mjedis

Z. Ali Ahmeti, drejtor i Departamentit për Zhvillim dhe Mbrojtje të Mjedisit të Trepçës, në prezantimin e tij tregoi se deponitë kryesore të mbetjeve industriale gjenden në 6 komuna: Leposaviq, Zveçan, Mitrovicë, Prishtinë, Graçanicë dhe Artanë. Mbetjet industriale kanë shkaktuar ndotje të mëdha të ujërave, pasi ato janë të vendosura afër lumenjve, dhe se përveç kësaj kontribuojnë në ndotjen e ajrit dhe në kontaminim e tokës bujqësore. Z. Ali Ahmeti shfaqti fotografi, të cilat e tregonin qartë problemin e emetimit të pluhurit nga deponitë aktuale.

Strategjia minerare e Kosovës dhe politikat mjedisore

Z. Kemajl Zeqiri, shef i sektorit për strategjinë minerare nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), bëri një paraqitje të përpjekjeve të bëra nga ministria e tij në përfundimin e një kornize ligjore për industrinë e nxjerrjes së mineraleve. Ai i përmendi radhazi objektivat kryesore të strategjisë minerare, si në vijim:

1. Reformimi dhe zhvillimi i sektorit minerar sipas qasjes Evropiane dhe praktikave më të mira për të mundësuar riaktivizimin e shpejtë dhe të qëndrueshëm të tij nëpërmjet investimeve kryesisht private.
2. Lehtësimi i çështjeve sociale dhe trajtimi i mjedisit sipas standardeve më të mira për zhvillimin e qëndrueshëm.
3. Zhvillimi institucional dhe ngritja profesionale e punonjësve të sektorit minerar për t'iu përgjigjur sfidave për një zhvillim të qëndrueshëm social, mjedisor dhe ekonomik.
4. Hulumtimi i plotë i rezervave minerale, raportimi i tyre në përputhje me standardet botërore dhe alokimi i tyre.
5. Promovimi i investimeve për shfrytëzimin racional të burimeve minerale përmes aplikimit të teknologjive më të përparuara.
6. Planifikimi dhe zhvillimi i sektorit minerar, në pajtim me standardet evropiane, në harmoni me planin nacional zhvillimor dhe planet zhvillimore komunale.

Z. Zeqiri në fjalën e tij e mbështeti komentin e z. Shala për ta trajtuar ndarazi kontaminimin e trashëguar dhe veprimtarisë aktuale dhe të ardhshme të Trepçës.

Cilësia e mjedisit në rajonin e Mitrovicës pas eksploatimit në shkallë të gjerë të mineraleve nga Ndërmarrja Trepça

Z. Luan Shllaku, drejtor i Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur – KFOS, e përmendi se cilësia e mjedisit në rajonin e Mitrovicës është ndikuar nga faktorë fizik dhe teknologjik, si: i) dendësia dhe pozita e hapësirave banuese në afërsi të lokacioneve minerare, metalurgjike dhe të deponive të mbetjeve (p.sh., qytetet e Mitrovicës dhe Zveçanit janë të rrethuara me një varg minierash, Ndërmarrjeesh të përpunimit dhe kimike, si dhe deponitë atypari të mbetjeve industriale); ii) shfrytëzimi i teknologjisë së vjetruar

Foto 2.
Emetimi i pluhurit
në deponinë
e Graçanicës



për përpunimin e metaleve, mungesa e filtrave elektrostatik për ta zvogëluar emetimin e gazit – emetimin e pluhurit në ajër dhe mungesën e objekteve për trajtimin e mbetjeve të lëngshme – të minierave ekzistuese dhe të Ndërmarrjeve të tjera përpunuese.

Z. Shllaku paraqiti të dhëna lidhur me sasinë e liruar të metalit në ajër në formë të emetimit, si dhe në ujë (shkarkimi i mbetjeve të lëngshme) nga ndërmarrja e Trepçës gjatë viteve të 80-ta të shekullit XX. Sipas këtyre të dhënave, Trepça emitonte në ajër: 1 215 tonë/në vit plumb, 60 tonë/në vit zink (vetëm nga burimi kryesor), 2 tonë/në vit kadmium dhe 6 tonë/në vit merkur, etj. Shkarkimi i ndotësve në ujë u vlerësuan të jenë: 150 tonë në vit plumb, 300-900 tonë në vit zink, 900 tonë në vit fluor, etj. Ai po ashtu vërejti se ndotja nga Trepça sa i përket emetimit ishin shumë më të larta sesa të dy termocentralet Kosova A dhe B.

Gjithashtu, ai vërejti se të dhënat për ndotjen aktuale nga Trepça nuk janë shumë reale pasi shumica e minierave të Trepçës dhe Ndërmarrjet metalurgjike nuk janë aktive. Si rrjedhojë, kur flitet për ndikimin në mjedis duhet t'i referohemi të dhënave të viteve të 80-ta, të cilat paraqesin të dhëna më të sakta për nivelin e parashikuar të ndotjes nga Trepça kur funksionon me tërë kapacitetet e saj.

Gjendja e mjedisit në pikat e nxehta

Përfaqësuesi i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, MMPH, z. Ilir Morina, Krye-shef ekzekutiv në Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), dha informacione se AMMK-ja në kuadër të mandatit të saj i ka identifikuar 110 pika të nxehta në tërë Kosovën, prej të cilave 28 sosh janë klasifikuar si lokacione tejet të rrezikshme në bazë të mundësisë për degradim mjedisor dhe për shëndetin e njerëzve. Po ashtu, ai theksoi se menaxhimi i mbetjeve industriale kërkon një kornizë të përshtatshme ligjore, të cilën nuk e ka tash për tash Kosova.

Deponitë e Trepçës dhe minierat e Trepçës – problemet mjedisore – një përmbledhje e zgjidhjeve

Profesori Frank Riesbeck nga Universiteti Humboldt në Berlin, Departamenti i Ekologjisë dhe Shfrytëzimit të Rezervateve, në prezantimin e tij dha një përmbledhje të problemeve mjedisore që burojnë prej: procesve minerare; drenazheve minerare acidike; grumbulluesve; deponitë; klasifikimin e parkut industrial të Mitrovicës (metalurgjia e zinkut) dhe shkretorja e Zveçanit si pikat më kritike të cilave duhet t'u kushtohet vëmendje e veçantë dhe që të merren veprime të menjëhershme. Më tej, i elaboroi rreziqet më të mëdha mjedisore që kanë të bëjnë me deponitë e mbyllura, me ose pa rifillimin e punës në grumbulluesit në Leposaviq, Tuneli i Parë dhe në Kishnicë. Ndikimet kryesore janë:

- kontaminimi i ujërave nëntokësore nën deponitë e mbyllura nga rrjedhja e metaleve nga deponitë,
- kontaminimi i sedimenteve dhe ujërave sipërfaqësore nga materialet e deponive të cilat shkaktojnë erozion të sipërfaqes së deponive si dhe të shkarkimit të ujërave të kontaminuara nëntokësor në sipërfaqe,
- kontaminimin e ajrit nga retet e pluhurit nga deponitë gjatë erërave në periudhat me mot të thatë,
- kontaminimi i tokës bujqësore nga deponimi i pluhurit të depozituar nga deponitë e mbyllura,
- kontaminimi i hapësirave të banimit, rrugëve dhe shesheve publike nga deponimi i pluhurit të depozituar nga deponitë e mbyllura.

Ai po ashtu i paraqiti në mënyrë skematike disa prej praktikave më të mira të rehabilitimit/rikultivimit të deponive sipas përvojës gjermane.

Prof. Frank Riesbeck iu referua rëndësisë së industrisë minerare dhe metalurgjike për ringjalljen dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës. Ai vërejti se industria e minierave në Gjermani ishte industria kryesore për rindërtimin dhe zhvillimin e pas luftës; industria minerare në Norvegji gjatë viteve të 60-ta ishte industria kryesore për rritjen e begatisë së vendit dhe se industria e minierave ende kontrollohet nga shteti; sektori i minierave dhe i energjisë mbesin shtyllat kryesore për zhvillim ekonomik për shumë vende të Evropës dhe të Azisë, dhe se ende janë nën pronësi shtetërore, p.sh: Suedia, Finlanda, Franca, Turqia, Kina, Rusia, etj. Si e tillë, industria minerare në Kosovë, sugjeroi ai, do të vazhdojë të jetë pronë e shtetit, megjithatë, i tërë sektori minierar, në veçanti ndërmarrjaminear i Trepçës, duhet të reformohet dhe ristrukturohet. Korniza ligjore në lidhje me industrinë minerare duhet të shoqërohet dhe të harmonizohet me direktivat përkatëse evropiane, reformat dhe ristrukturimi do të zbatohet dhe se roli i shtetit duhet të jetë i qartë dhe i përkufizuar në sektorin minierar. Çfarëdo reforme ose procesi i ristrukturimit që do të ndodh detyrimisht do t'i trajtojë çështjet mjedisore, shoqërore dhe aspektet e zhvillimit ekonomik.

Trajtimi i pikave të nxehta (përvoja) dhe gjendja e mjedisit në parkun industrial të Mitrovicës

Z. Jiri Kubricht, menaxher projektsh në kompaninë çeke Dekonta, dha hollësi për procedurat e aplikueshme për rehabilitimin e deponive të mbyllura në republikën çeke dhe përvojën e kompanisë së tij në zhvillimin e vlerësimit të ndikimit në mjedis në parkun industrial të Mitrovicës. Ai shtoi se përfundimet dhe rekomandimet përfundimtare për trajtimin/masat korrektuese janë përshkruar në raportin përfundimtar për EIA, dhe e cila i është dorëzuar edhe palëve vendore.

TEMA 2:

Aktivitetet minerare / metalurgjike të Trepçës dhe ndikimi i tyre në shëndetin e njerëzve

Ndikimi i kontaminimit të mjedisit me plumb për shëndetin e njeriut në rajonin e Mitrovicës

Dr. Dorit Nitzan nga OBSH-ja shpjegoi se kurdoherë që flasim për mbetjet industriale, plumbi përdoret si tregues i ndotjes. Ajo theksoi se fëmijët përbëjnë grupin më të ekspozuar ndaj kontaminimit me plumb, për shkak të potencialit absorbues që kanë në krahasim me të rriturit. Fraksioni i absorbit është 40% te fëmijët kundrejt 10% te të rriturit. Simptomat kryesore të helmimit me plumb janë: koeficienti i ulët i inteligjencës, dhimbje barku dhe rritje të ngadalshme. Helmimi me plumb zakonisht është kronik ose pothuajse kronik. Helmimi akut është mjaft i rrallë në shumë vende, porse ende shfaqet pas ndonjë ekspozimi masiv. Në shumicën e vendeve të industrializuara, ku helmimi me plumb është zakonisht mesatar dhe kronik, fëmijët e helmuar identifikohen me një analizë të nivelit të plumbit në gjak (BLL) dhe jo sipas manifestimit të tyre klinik.

Në rajonin e Mitrovicës gjendja më kritike është me bashkësinë RAE për shkak të afërsisë ku jetojnë dhe pengesave shoqërore për t'u vizituar nga kujdesi mjekësor. Dr. Nitzan e theksoi se Instituti nacional për shëndetin publik në Prishtinë dhe njësitë e saja në Mitrovicë, të cilat kanë kapacitet dhe pajisje për matjen e nivelit të plumbit në gjak, gjersa asnjë vend tjetër në rajon nuk ka kapacitete të tilla.

Bujqësia urbane dhe në periferi si rrugë për thithjes së ndotësve të rëndë të metalit nga njeriu

Znj. Dorothy Sanders shkurtimisht e shpjegoi bazën e hulumtimit të saj që e kishte bërë gjatë vitit 2010 në rajonin e Mitrovicës. Në studimin e saj e analizonte absorbimin e metaleve të rënda në të mbjellat për ushqim nga dheu + modelet e parashikueshme të bartjes dhe të rrugëve përmes dheut-bimëve-absorbimit si dhe rrezikut për shëndetin e njerëzve. Hulumtimi mbulonte një hapësirë prej 160 km².

Akumulimi i ndotësve të metaleve të rënda në tokën bujqësore dhe në të mbjellat që përdoren për ushqim për shkak të veprimtarisë së minierave dhe të shkretoreve është një problem shqetësues mbarëbotëror për shëndetin e njeriut;

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se sipërfaqja e tokës është e ndotur shumë, me vetëm dy për qind të mostrës nën nivelin natyror bazë gjeokimik. Pb paraqet rrezikun më të madh me 76% të mostrës së dheut që e tejkalon nivelin bazë dhe me 42% të tejkallimit të kufijve maksimal të lejueshëm ndërkombëtar.

Koncentrimi i lartë i metaleve të rënda në të mbjellat doli të jetë i ndryshëm varësisht prej llojit të perimeve, dhe që i tejkalonte kufijtë e lejueshëm maksimal ndërkombëtar për Pb në 64% të mostrës së matur. Rreziku për shëndetin e njeriut përmes zinxhirit ushqimor binte në këtë renditje $Pb > Zn > Cd > Cu$, ku rreziqet më të mëdha vinin prej konsumimit të perimeve bishtore.



Figura 1. Rrugët e absorbimit të metaleve të rënda: 'dheu-bima-njeriu'

Absorbimi i tyre mund të ndodhë përmes mënyrash të ndryshme, duke përfshirë zinxhirin ushqimor, thithjen e pluhurit që ngrihet nga era, si dhe përmes absorbimit direkt nga dheu.

Rezultatet e këtij studimi tregojnë qartë se duke i përzgjedhur disa perime të veçanta është e mundur të zvogëlohet rreziku i ekspozimit të njeriut ndaj kontaminimit të dheut nga metalet e rënda, sidomos përmes zinxhirit ushqimor. Sipas vlerësimeve të rrezikut mjedisor dhe shëndetësor të bërë në perimet dietare kryesore në kuadër të këtij hulumtimi mund të nxirren përfundime se prej mostrës së marrë, bizelja përmban nivelin më të lartë e cila i tejkalon kufijtë maksimal të metaleve të rënda në ushqim, dhe se është akumulues i madh i Pb, Zn, Cd dhe në një farë mase të Cu. Përveç kësaj, karota, lakra, qepa, speci, patatja dhe domatja u identifikuan të gjitha si akumulues të lartë të Pb, në veçanti lakra, dhe se patatja u identifikua si akumulues mjaft i lartë i Cd.

Andaj, rekomandohet që popullsia lokale në rajonin e Mitrovicës duhet t'i shmanget konsumimit të perimeve të sipërpërmendura, posaçërisht të bizeles, me qëllim të zvogëlimit të rreziqeve të mëdha shëndetësore prej metaleve të rënda. Në anën tjetër, sugjerohet që perimet frutore, në veçanti trangulli, janë më të sigurt që të konsumohet pasi njihen si akumulues më të vegjël të metaleve të rënda në krahasim me të tjerët.

Figura 2: Niveli i plumbit në gjak dhe ndikimi i tij në shëndetin e njeriut

Një nevojë urgjente është zhvillimi i një vlerësimi gjithëpërfshirës, i shkallës së plotë, të ekspozimit të popullatës ndaj metaleve të rënda. Përveç kësaj, programet për përmirësimin e tokës bujqësore janë më së të nevojshme sa më parë.

TEMA 3:

Strategjitë lehtësuese – praktikat më të mira ndërkombëtare për përmirësimin dhe zhvillimin ekonomik

Rreziqet e vazhdueshme nga deponitë e mbetjeve, rrugët kryesore të kontaminimit, masat e nevojshme për zvogëlimin e rrezikut

Z. Pier Carlo Sandei nga UNEP dha shpjegime themelore për terminologjinë e deponive dhe llojeve të pendëve të deponive, duke përfshirë parametrat e dizajnit që janë marrë parasysh gjatë ndërtimit të deponive për ruajtjen e sigurt të materialeve të hedhura, për monitorimin e tyre, vlerësimin e rrezikut dhe përgatitjet për raste emergjente.

Ai theksoi se menaxhimi i keq i ujit përreth pendës së deponisë ose të deponive paraqet të shpeshtën e herëve arsyen kryesore të prishjeve të pendëve të deponive. Në këto raste ndodhin aksidente ku kemi rrjedhje të përmasave gjatë të reshurave të mëdha, erozionin e pendëve prej ujërave nëntokësore dhe të atyre sipërfaqësore të cilat futen në zonën e pendës.



*Foto 3.
Shkatërrimi
i pendës së deponisë në
Hungari në vitin 2010.*

Aktivitetet përmirësuese në 8 lokacione të nxehta në Ballkanin perëndimor

Menjëherë pas konferencës, z. Stewart Williams) i ftoi pjesëmarrësit që ta shikojnë një video të cilën e kishte përgatitur UNDP-ja si pjesë e Projektit të pikave të nxehta që u realizua prej vitit 2007-2010. Videoja përqendrohej në tetë lokacione të nxehta ku tregohesh dhe krahasohej gjendja e mëparshme dhe pas rehabilitimit të atyre lokacioneve në Shqipëri (Bajca), në Bosnje dhe Hercegovinë (Tuzlla), në Maqedoni (Bucim dhe Vrapciste), në Malë të Zi (Mojkovce), në Kosovë (Trepçë/Artanë dhe Staritërg), dhe në Serbi (qyteti Vrbas).

Iniciativat e ENVSEC në lidhje me menaxhimin e mbetjeve industriale

Z. Laura Rio nga Iniciativa për siguri të mjedisit (ENVSEC) i informoi pjesëmarrësit se kjo iniciativë është në partneritet me Programin për zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), Programin për mjedis të Kombeve të Bashkuara (UNEP), Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Komisioni për ekonomi të Kombeve të Bashkuara për Evropë (UNECE), Qendra rajonale e mjedisit për Evropë qendrore dhe lindore (REC) dhe Organizata Veri-Atlantike (NATO).

Iniciativa ENVSEC është aktive në Evropën juglindore, kaukaz dhe Azi qendrore. Në Ballkanin perëndimor ENVSEC, në mesin e prioriteteve të saj, kërkon të promovojë zvogëlimin e rreziqeve mjedisore dhe ato që kanë të bëjnë me shëndetin e njeriut që vijën për shkak të standardeve të ulëta gjatë veprimtarive në miniera, duke e përmirësuar bashkëpunimin rajonal për menaxhimin e rrezikut në ndotjen në pikat e nxehta si dhe në menaxhimin ndërkuftar të pasurive të përbashkëta natyrore.

Në Ballkan, ENVSEC përqendrohet në katër fusha kryesore: i) miniera; ii) menaxhimin e hapësirave të mbrojtura ndërkuftare; iii) bashkëpunimin rajonal, dhe iv) adaptimin me ndryshimet klimatike. Përmes fondeve të ENVSEC financohet aktualisht një studim fizibiliteti për trajtimin e ujërave acidike nga miniera në Artanë.

ENVSEC pret të jetë pjesë e grupit punues që të nxjerrë nga rezultatet e konferencës për Trepçën dhe të paraqes projekte dhe plane për donatorët që janë aktiv në Kosovë. ENVSEC mund të ndihmojë në mobilizimin e resurseve, vazhdimin e mbështetjes për studime dhe vlerësim, si dhe për pasuruar aktivitetet me prioritet, duke përfshirë edhe mbështetjen e seminareve rajonale. Po ashtu, mund t'i mobilizojë ekspertët dhe të sigurojë mbështetje nga organizatat e tjera ndërkombëtare për intervenimin në drejtim të përmirësimit mjedisit të shëndosh dhe sigurisë në Trepçë.

Koncepti i përmirësimit të deponive në Evropën juglindore, shembuj nga Kosova, Serbia, Mali i Zi, Rumania dhe Gjermania

Z. Nikolaus Linder, nga kompania “Fichtner Mining & Environment GmbH”, i paraqiti disa shembuj të kompanisë së tij të përfshirë në Kosovë, dhe rehabilitimin e lokacioneve me deponi dhe trajtim të ujërave acidik të minierave në Mal të Zi – miniera në Mojkovac, në Serbi – miniera në Bor, Rumania – miniera në Baia de Aries dhe shembuj nga Gjermania – miniera Pöhla.



Foto 3.
Trajtim i plotë i ujërave
acidike të minierave në
Gjermani –Pöbla

Lista e prioriteteve në fushën e rikultivimit të zonave të kontaminuara dhe të menaxhimit të mbetjeve industrial të Ndërmarrjes së minierës Trepça

Profesor Frank Riesbeck, nga Universiteti Humboldt në Berlin në prezantimin e dytë të tij e shtjelloi nevojën për një proces gjithëpërfshirës të planifikimit, i cili duhet të bëhet për zvogëlimin e kontaminimit të ujit, dheut dhe ajrit që ka ndodhur për dekada të tërë gjatë funksionimit të Trepçës. Nevojiten veprime të menjëhershme për ta garantuar sigurinë e kushteve të punës në Ndërmarrje dhe në miniera, si dhe një bashkëpunim me bujq të zonës për ta hulumtuar kontaminimin e tokës bujqësore.

Intervenimet më urgjente, në bazë të vizitave të bëra më herët në lokacionet në fjalë janë renditur si më poshtë:

- Deponia në Parkun industrial të Mitrovicës në Mitrovicë
- Uji acidik i minierave në lokacionin e minierës së Artanës
- Deponia në Kishnicë dhe Graçanicë
- Deponia e metalurgjisë së plumbit në Zveçan
- Deponia e Kelmendit te tuneli i parë
- Deponia nga njësitë e flotacionit në Leposaviq

Përveç përmirësimit/rikultivimit të lokacioneve të deponive duhet të ndërmerren edhe masa të tjera institucionale dhe administrative, si:

- Është i nevojshëm procesi i ristrukturimit të industrisë minerare në Kosovë, duke e vënë në krye të listës si prioritet Ndërmarrjen Minerare të Trepçës
- Zbatimi i plotë i Ligjit për Miniera dhe të legjislacionit mbështetës
- Zbatimi i strategjisë minerare 2010-2025
- Hartimi i ligjit të ri për mbetjet nga industria e nxjerrjes minerare (zbatimi i direktivës së BE-së 2006/21/EU)
- Hartim i ligjit të ri ose rregullores për mbetjet historike të shkaktuara nga industria e nxjerrjes minerare, rregullore për lokacionet e kontaminuara dhe depozitat e vjetra.

Paralelisht me këto masa, institucionet e Kosovës duhet t'i kushtojnë vëmendje gjendjes sociale në rajon, duke i përfshirë në projektet e rehabilitimit dhe të rikuperimit punonjësit e mëhershëm dhe ata të papunësuar të minierës.

Intervenimet në lokacionet minerare nga UNDP/UNEP në Ballkanin Perëndimor

Z. Stewart Williams, këshilltari kryesor teknik i njësisë së programit rajonal - UNDP në Mal të Zi, dha shpjegime të hollësishme lidhur me intervenimet që kanë ndodhur si pjesë e iniciativës për “Forcimin e kapaciteteve të vendeve të Ballkanit perëndimor për trajtimin e problemeve mjedisore përmes përmirësimit të të pikave të nxehta me prioritet të lartë”. Si pjesë e kësaj iniciative janë rehabilituar lokacionet në vijim:

Vendi	Lokacioni	Problemi	Intervenimi	Kostoja (USD)
Shqipëri	Repshe	Penda e deponisë	Restaurimi i integritetit të pendës	190 000
	Rrëshen	Penda e deponisë	Restaurimi i integritetit të pendës	220 000
Mal të zi	Mojkovac	Penda e deponisë	Stabilizimi i deponisë	1 200 000
Kosovë	Kelmend	Penda e deponisë	Mbulimi i pjesshme dhe mbajtja nën kontroll	200 000
	Artana	Deponi të mbuluara (T2)	Mbajtja e përkohshme nën kontroll dhe mbulimi	270 000
		Depni të mbuluara (T1)	Mbajtja e përkohshme nën kontroll	190 000
	Kishnica	Deponi të ripërpunimit	Rikuperimi i plumbit dhe zinkut	na
Ish republika jugosllave e Maqedonisë	Bucim	Drenazhimi i acidit mineral	Zërja dhe mbulimi	601 000
		Zvogëlimi i pluhurit	Rikultivimi dhe shpërndarja e avujve	205 000
		Rikuperimi i bakrit	Rikuperimi i bakrit nga AMD	na
	Lojane	Mbetja minerare/e përpunimit	Mbulimi dhe mbajtja nën kontroll	240 000

Masat përmirësuese afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata – prezantim i projekt-propozimeve

Znj. Nezakete Hakaj, shefe e divizionit për mbrojtje të mjedisit, MMPH, në prezantimin e saj e paraqiti një listë të masave që nevojiten të zbatohen për zvogëlimin e degradimit të mjedisit dhe të ndikimit sa më të vogël në shëndetin e njeriut. Intervenimet janë renditur në katër grupe kryesore të masave: i) trajtimi i ujërave që dalin nga minierat; ii) rehabilitimi i lokacioneve të deponive; iii) rehabilitimi i tokave bujqësore, dhe iv) fushatat e vetëdijesimit. Në kuadër të secilit grup janë propozuar veprime konkrete të cilat janë elaboruar në tabelën në vijim:

Nr.	Lokacioni	Përshkrimi i intervenimit	Prioriteti	Kostoja (Euro)
i	Artanë	<ul style="list-style-type: none"> Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave acidike minerare në Artanë 	Shumë i lartë	~ 300 000
	Tuneli i parë	<ul style="list-style-type: none"> Studim i fizibilitetit për vlerësimin e kërkesave për trajtim (trajtim aktiv ose pasiv) Ndërtimi i impiantit për trajtim të ujit të shkarkuar minerar nga njësia e flotacionit në Tunelin e parë 	I ulët	~ 15 000 ~ 300 000
ii	Parku industrial i Mitrovicës	Rehabilitimi i deponisë së parkut industrial të Mitrovicës <ul style="list-style-type: none"> Pastrimi i shtratit dhe i brigjeve të lumit Sitnica dhe ndërtimi i murit ndarës përgjatë mbetjeve industriale dhe lumit Rrethimi i mbetjeve industriale në parkun industrial të Mitrovicës (sipërfaqja 35 ha, shuma) Instalimi i gypave të drenazhes për mbledhjen e ujërave që rrjedhin nga materialet mbetje dhe transportim i tyre në impiantin për trajtimin e ujërave acidike. 	Shumë i lartë	~ 2 000 000 ~ 1 000 000 ~ 700 000
	Deponia e Kelmendit	<ul style="list-style-type: none"> Rrethimi i mëtejshëm dhe rikultivimi i deponisë së Kelmendit 	I lartë	~ 650 000
	Lokacioni metalurgjik dhe i llumit të plumbit në Zveçan	Përmirësimi dhe mbulimi i deponive në Gornje Poje dhe Zitkovac <ul style="list-style-type: none"> Pastrimi i shtratit dhe i brigjeve të lumit nga mbetjet industriale, duke përfshirë ndërtimin e mureve ndarëse mes deponisë dhe lumit Ibër për ta parandaluar bartjen e mbetjeve materiale, duke përfshirë mbulimin me shtresa të reja të tokës 	I lartë	~ 6 800 000
	Deponia e Graçanicës	Rehabilitimi i mëtejshëm i deponisë në Graçanicë <ul style="list-style-type: none"> Rrethimi dhe rikultivimi i deponisë në Graçanicë 	I lartë	~ 300 000
	Miniera e Artanës	Rrethimi i deponisë në Artanë (T2)	I mesëm	
	Rajoni i Mitrovicës	Rehabilitimi i tokës bujqësore dhe i hapësirave publike në rajonin e Mitrovicës <ul style="list-style-type: none"> Kryerja e hulumtimeve për ta vlerësuar kontaminimin e tokës bujqësore dhe heqja e kontaminimit Ndërmarrja e masave përmirësuese për zëvendësimin e shtresës së sipërme të dheut (15-25 cm) të tokës bujqësore, vendbanimeve dhe vendeve publike 	Shumë i lartë	~ 450 000 ~ 7 500 000 – 10 000 000
iv	Gjithandej Kosovës	Fushata të vetëdijesimit për promovimin e praktikave më të shëndosha në zonat e kontaminuara.	Shumë i lartë	500 000

Znj. Nezakete Hakaj shtjelloi se rehabilitimi i deponive, pastrimi i hapësirave publike dhe vendbanimeve; rehabilitimit i tokës bujqësore do të kontribuonin në një jetë më të mirë për njerëzit në rajonet e ndikuara, dhe se do të zvogëlonte kërcënimin mjedisor dhe për shëndetin e njeriut, e po ashtu do ta ngrinte bashkëpunimin e gjerë, dhe së fundi do ta ngrinte vetëdijen për investime të reja.

Përmbledhje e konferencës

Në fund të konferencës, palët kryesore të përfshira MMPH, MZHE, komuna e Mitrovicës, Ndërmarrja Trepça dhe UNDP-ja në Kosovë u pajtuan që ta themelojnë një grup punues me detyrë të përmbledhjes së konkluzioneve dhe rekomandimeve të dala nga konferenca dhe përgatitja dhe vënia e prioriteteve për intervenimet që nevojiten të zbatohen si pjesë e strategjisë afatshkurtër dhe afatgjatë si zgjidhje e problemit të mbetjeve industriale.



Përmbledhje e rekomandimeve nga Konferenca për Menaxhimin e Mbetjeve Industriale të Ndërmarrjes Trepça -

Objektivat e konferencës

Objektivat kryesore të konferencës për menaxhimin e mbetjeve industriale të Ndërmarrjes Trepça të mbajtur më 19-20.09.2011 në Mitrovicë ishin:

- Të kuptuarit e ndikimit në mjedis dhe shëndetin e njeriut të mbetjeve industriale të gjeneruara nga ndërmarrja Trepça
- Shkëmbimi i njohurive dhe përvojave mes ligjëruesve vendorë dhe ndërkombëtar për rehabilitimi/rikultivimin e lokacioneve me deponi të mbetjeve industriale

- Arritja e konsensusit për një plan të përbashkët të veprimit dhe krijimi i strukturave zyrtare të bashkërendimit që përbëhen prej aktorëve zhvillimor, institucioneve dhe industrisë për t'i trajtuar prioritetet dhe monitorimi i përbashkët i iniciativave të ndryshme lidhur me mbetjet industriale
- Bashkërendimi më i mirë dhe të kuptuarit e planeve dhe të aktiviteteve të palëve të ndryshme të interesit, duke përfshirë konfirmimin e një varg intervenimesh të menjëhershme dhe afatgjata.

Plotësimi i kornizës ligjore në sektorin e minierave

Institucionet e Kosovës do të bëjnë përpjekje për hartimin, miratimin dhe zbatimin e legjislacionit të nevojshëm në lidhje me sektorin e minierave. Hapat më urgjent që duhet të ndërmerren janë:

- Hartimi dhe miratimi i Ligjit për menaxhimin e mbetjeve të industrisë së nxjerrjes së mineraleve (ligji duhet të jetë në harmoni të plotë me direktivën evropiane 2006/21/EC)
- Miratimi dhe zbatimi i Strategjisë minerare të Kosovës
- Zbatimi i Ligjit për miniera dhe minerale

Përveç këtyre, është e nevojshme që të kihet një strategji gjithëpërfshirëse për ristrukturimin e Ndërmarrjes Trepça.

Kontaminimi historik dhe veprimtaria aktuale e Trepçës

Të gjithë folësit e pranuan se industria minerare e Trepçës ishte shtylla kryesore e ekonomisë së Kosovës dhe se pasuritë e saj minerale paraqesin potencialin më të madh për zhvillimin e ardhshëm ekonomik të saj. Andaj, kontaminimi historik dhe veprimtaria aktuale e Trepçës duhet të trajtohen veçmas. Mbetjet industriale të gjeneruara në të kaluarën nuk duhet të jenë barrë e procesit të ristrukturimit të ardhshëm të Trepçës.

Harmonizimi i të dhënave ekzistuese lidhur me mbetjet industriale

Palët e interesit do të bashkërendohen mes veti për t'i harmonizuar të dhënat ekzistuese lidhur me mbetjet industriale. Të dhënat e konsoliduara do të përfshijnë informacionin në vijim:

- Shuma totale e mbetjeve industriale të deponuara në secilin lokacion të deponive, si të atyre aktive edhe të atyre pasive (që nuk janë në përdorim),
- Shuma (koncentrimi) i metaleve industriale në mbetjet industriale (për secilin lokacion të deponive të mbetjeve industriale)
- Statusi dhe kushtet e lokacioneve të deponive të mbetjeve industriale (aktive dhe pasive)
- Intervenimet/ punimet rreth rehabilitimit që janë zbatuar në të kaluarën dhe palët e përfshira

Promovimi i konceptit për zhvillim të qëndrueshëm

Koncepti i “Shfrytëzimit racional të pasurive natyrore” dhe i “Zhvillimit të qëndrueshëm” do të mishërohen në Strategjinë kombëtare për zhvillim ekonomik. Koncepti i “zhvillimit ekonomik së pari, dhe pastrim më vonë” është një koncept i vjetruar dhe opsion jashtë përdorimit.

Plani i veprimit dhe prioritizimi i intervenimeve në lokacionet e mbetjeve industriale

Duhet të hartohet plani i veprimit me masa për rehabilitimin e lokacioneve me mbetje industriale. Në tabelën në vijim janë përmbledhur intervenimet që janë prioritizuar dhe konfirmuar nga palët vendore të interesit. Është dhënë një përshkrim i shkurtër i secilit intervenim, prioritet për zbatim dhe vlerësimi i përafërt i kostos për secilin propozim.

Propozimet për aktivitetet e pastrimit të dhëna gjatë konferencës për menaxhimin e mbetjeve industrial të Ndërmarrjes Trepça

#	Përshkrimi i aktiviteteve
I. INTERVENIMET E MENJËHERSHME	
1	STUDIMI I FIZIBILITETIT PËR DEPONITË Janë zhvilluar një varg studimesh prej agjencive të ndryshme dhe instituteve kërkimore gjatë dekadës së fundit në lidhje me mbetjet industriale që kanë rezultuar prej Ndërmarrjes minerare dhe metalurgjike Trepça. Megjithatë, ekziston një llojshmëri e të dhënash në dispozicion lidhur me koncentrimin e metaleve në mbetjet industriale, në lidhje me shumën e mbetjeve në deponi, nëse ripërpunimi i mbetjeve industriale është një opsion dhe për cilat deponi. Studimi do të mbledh të dhëna bazë për mbetjet industriale të cilat do të përdoren si bazë për planifikimin dhe fazën dizajnuese, pastaj do të ofrojë opinionin e ekspertëve nëse ripërpunimi është një opsion dhe për cilat mbetje, dhe së fundi do ta shtjellojë opsionin më të mirë për përmirësimin e secilës deponi. Studimi do të fokusohet në të gjitha deponitë aktive dhe të braktisura në përcaktimin e parametrave në vijim: - përbërjen kimike të mbetjeve industrial (koncentrimi i metaleve të rënda) - sasinë dhe sipërfaqen që e mbulojnë materialet me mbetje industrial (mbetja e deponuar në secilën deponi) - dhënien e rekomandimeve nëse dhe cila mbetje industriale ka ende vlerë ekonomike dhe mbase mund të ripërpunohet në të ardhmen. - propozimi i mënyrave të rehabilitimit të deponive, duke i pasur parasysh nevojat e lokacionit. Prioriteti: Shumë i lartë Ky studim do të kontribuojë në të dhëna të konsoliduara dhe të besueshme që është një parakusht për zhvillimin e propozimeve për rehabilitimin dhe për zbatimin e punimeve. Buxheti: Buxheti i përgjithshëm për këtë aktivitet vlerësohet ndërmjet 250 000 – 350 000 euro .

2

NDËRTIMI I IMPIANTIT DRENAZHUES PËR TRAJTIMIN E ACIDIT MINERAR (AMD) NË LOKACIONIN MINERAR TË ARTANËS



*Foto:
Shkarkimi i
ujërave acidike
në lumin e
Artanës*

TLokacioni mineral i Artanës gjendet në pjesën lindore të Kosovës, dhe se është pjesë integrale e ndërmarrjes Trepça. Ky lokacion mineral është identifikuar si njëri prej pikave më të nxehta mjedisore dhe komplekse në rajon për dy arsye:

- i) mbetja industrial përmban koncentrim të lartë të metaleve të rënda IS që janë deponuar në ujërat e afërta; dhe
- ii) materiet acidike që dalin nga mineral (përmbajnë koncentrik të lartë të metaleve të rënda) shkarkohen drejtpërdrejtë në lumin Kriva Reka pa ndonjë trajtim të mëparshëm. Lumi Kriva Reka ka ndikim të drejtpërdrejtë në ujin e pijshëm që vijën prej ujërave të qytezës së Kamenicës (qytezë me 13 000 – 15 000 banorë). Të dy deponitë ishin rehabilituar përmes qeverisë holandeze që janë mbështetur financiarisht dhe mbështetur prej UNDP-së (2007-2010). Sa i përket drenazhes së acidit mineral (AMD) është duke u zhvilluar studimi i fizibilitetit për trajtimin e AMD-së. Objektivi i studimit është që të ofrojë analiza të qarta, rekomandime, kosto indikative (operacionale dhe të ndërtimit), performancën e përgjithshme të impiantit për trajtimin e AMD-së (p.sh. efikasiteti në heqje) dhe një dizajn të përgjithshëm për sistemet pilot të trajtimit.

Intervenimet e nevojshme

Përgatitja e dizajnit përfundimtar për rehabilitim + zbatim të punimeve:

- i) Ndërtimi i impiantit për trajtim të

Prioriteti i intervenimit: Shumë i lartë

Buxheti: Buxheti i përgjithshëm për këtë aktivitet është vlerësuar të jetë 300 000 euro.

Studimet e bëra:

1. MONTEC (2007), Final Report: Environmental assessment and Remedial Action Plan (EARAP): Stan Trg/Stari Trg and Artana/Novo Brdo Mines, Kosovo, UNDP Kosovo, Environmental Assessment and Remedial Action Plan (EARAP): Stanterg/Stari Trg and Artana/Novo Brdo Mines Project.

3 REHABILITIMI I PARKUT INDUSTRIAL TË MITROVICËS



Foto. Zona e Parkut Industrial të Mitrovicës

reaMIP paraqet burimin më të rëndë kontaminues për mjedisin dhe ekosistemin në komunën e Mitrovicës. Mbetjet industrial janë deponuar afër brigjeve të lumit Sitnica, në afërsi të spitalit të qytetit dhe brenda zonës së banimit. Mbetjet e parkut industrial të Mitrovicës e kontaminojnë ujin, ajrin dhe tokën bujqësore në tërë rajonin e Mitrovicës.

Prandaj, nevojiten intervenime urgjente për ta zvogëluar ndikimin negativ në shëndetin e njerëzve dhe të degradimit të mëtejshëm të mjedisit. Ndikimet ndërkuftare janë të rëndësishme po ashtu, pasi lumi Sitnica është degë e lumit Ibër (i cili shkon në Serbi) dhe drejtpërdrejtë ndikon në ujin e pijshëm për furnizim të atyre që e shfrytëzojnë këtë ujë.

Intervenimet e nevojshme

Përgatitja e dizajnit përfundimtar për rehabilitimin + zbatimin e punimeve brenda hapësirë së Parkut industrial të Mitrovicës, i cili përfshinë:

- i) Pastrimi i shtratit të lumit dhe brigjeve të tij, duke përfshirë ndërtimin e një muri ndarës/mbajtës/kontaminues mes deponisë dhe lumit për ta parandaluar bartjen/depërtimin e materialeve të kontaminuara të mbetjes dhe rrjedhjen e tyre në lum
- ii) Mbulimi dhe mbajtja nën kontroll e mbetjeve industriale sipas praktikave më të mira ndërkombe-tare dhe vegjetacioni (një hapësirë rreth ~35 Ha). Do të vendoset një shtresë sipërfaqësore e trashë prej minimum 40 cm të dheut mbi betoni në sipërfaqen e ndotur.
- iii) Instalimi i gypave të drenazhës Ø800mm për vijen krzesore të kanalizimit në të dyja anët e lumit në përputhje me planin e ardhshëm zhvillimor komunal të impiantit ekzistues të trajtimit të ujit me kapacitet të akomodoj mbi 200,000 persona .
- iv) Konstruksioni i elektrifikimit nëntokësorë (kanaleve/kablove nëntokësorë) në të dyja anët e lumit për ndricimin e parkut/hapësirës së gjelbërt në të ardhmen.
- v) Konstruksioni i dritave publike në tërë gjatësin (me energji të diellit) në të dyja anët e lumit.
- vi) Instalimi i gypave të drenazhës për t'i mbledhur materiet acidike përgjatë murit ndarës dhe bartjes së materieve acidike në impiantin ekzistues të trajtimit të ujit (impianti ekzistues në kuadër të kompleksit Trepça – Parku industrial i Mitrovicës).

Prioriteti i intervenimit: Shumë i lartë

Intervenimet në parkun industrial do të kontribuojnë në krijimin e kushteve për shfrytëzim alternative të asaj zone. Pozita gjeografike e parkut industrial është tejet praktike dhe ofron potencial të madh për zhvillimin e bizneseve të ndryshme dhe aktiviteteve rekreative ose për ndonjë qëllim tjetër (instalimi i penelave solar, etj.).

Buxheti: Buxheti i përgjithshëm për këtë intervenim vlerësohet të jetë 3 000 000 - 3 700 000 euro.

Studimet e bëra:

1. Consulting services for Environmental Assessment and Remedial Action Plan for Mitrovica Industrial Park, Kosovo, Dekonta Company 2010.
2. Humboldt - Universitat zu Berlin (2005), Ecological and Economical Assessment of Environmental Problems After Restarting the Lead Zinc Mining Process in the Trepca Mines Complex and the Connected Post-Refining Industrial Processes, Trepca Kosovo Under UNMIK Administration, Trepca Mines Feasibility Study Project.

II. MASAT PËRMIRËSUESE AFATSHKURTRA DHE AFATGJATA

4 RRETHIMI I MËTEJMË DHE RIKULTIVIMI I DEPONISË SË KELMENDIT



Deri më tani, kreshta kryesore e lokacionit të deponisë është mbyllur dhe rrethuar përmes fondeve nga qeveria e Holandës, dhe të zbatuar nga UNDP-ja. Megjithatë, ekziston edhe një hapësirë e konsiderueshme prapa dhe në fillim të kësaj sipërfaqe që ka nevojë të trajtohet. Studimet e bëra nga aktorë të ndryshëm, si UNDP-ja, OBSH-ja, KFOR, CDC dhe UNICEF-i në zonën e Mitrovicës e kanë identifikuar deponinë si burimi kryesorë për pluhurin e plumbit në këtë zonë, i cili me kohë, ka ndikuar në shëndetin e popullsisë lokale. Niveli i plumbit në gjak të fëmijët që janë marrë si mostër në këtë zonë është raportuar të jetë 40% mbi nivelin që gjykohet të jetë i sigurt nga OBSH-ja.

Andaj, kërkohen intervenime urgjente për ta zvogëluar ndikimin negativ në shëndetin e njerëzve dhe të degradimit të mëtejshëm të mjedisit.

Intervenimet e nevojshme

Përgatitja e një dizajni përfundimtar për rehabilitimit + zbatimin e punimeve në zonën e deponisë së Kelmendit, që përfshinë si në vijim:

- a. Kërkimet gjeo-mekanike për ta konfirmuar stabilitetin e pendës së deponisë, duke e pasur parasysh pjerrtësinë e mbeturinave të deponuara.
- b. Mbulimi dhe mbajtja nën kontroll e zonës prapa dhe përpara të kreshtës në bazë të përvojave më të mira ndërkombëtare dhe rikultivimi i saj (përafërsisht hapësira e deponisë ~8 Ha). Do të vendoset një shtresë e trashë e dheut të freskët prej 40 cm mbi mbetjet industriale.
- c. Menaxhimi i duhur i ujit që vjen në deponi, ri-aranzhimi dhe instalimi i sistemit të ri të drenazhës, nëse nevojitet, largimi i ujit nga bazeni (liqeni). Janë të nevojshme masat për sigurimin e zonës së bazenit për ta parandaluar qasjen e fëmijëve dhe kafshëve.

Prioriteti i intervenimit: Shumë i lartë

Buxheti: Buxheti i përgjithshëm për këtë intervenim është vlerësuar të jetë 550 000 – 650 000 euro.

Studimet e bëra:

1. MONTEC (2007), Final Report: Environmental assessment and Remedial Action Plan (EARAP): Stan Trg/Stari Trg and Artana/Novo Brdo Mines, Kosovo, UNDP Kosovo, Environmental Assessment and Remedial Action Plan (EARAP): Stanterg/Stari Trg and Artana/Novo Brdo Mines Project.
2. Golder Associates (2004), Reactivation and Final Closure Plan Preparation Prvi Tunel (Zarkov Potok) Tailings Dam, Kosovo, Trepca Kosovo Under UNMIK Administration.



Foto: impianti i metalurgjisë së zinkut dhe mbetjet industriale (lumë plumbi)

Deponia e Zitkovacit ndodhet në veriperëndim të Zveçanit dhe afër lumit Ibër. Shqetësim më të madh paraqet zona e deponisë në Gornje Polje në veri të brigjeve të lumit Ibër dhe afër Zveçanit dhe Mitrovicës. Kjo zonë jo vetëm që është afër lumit, mirëpo edhe një përroskë kalon mes përmes kësaj zone duke e ndarë deponinë në dy pjesë. Edhe pse pjesërisht me vegjetacion, zona është burim i pluhurit dhe kontaminimit të ujit, kryesisht përmes erozionit. Te dy pjesë e deponisë kapin një hapësirë më të madhe se 80 ha, dhe një deponi mbetjesh industriale që vlerësohet afërsisht prej 22 milion tonë.

Intervenimet e nevojshme

Përgatitja e dizajnit përfundimtar për rehabilitimin + zbatimin e punimeve në zonën e deponive të Gornje Poljes dhe Zitkovc, të cilat përfshijnë me sa vijon:

- i) Pastrimi i shtratit të lumit dhe brigjeve të lumit nga mbetjet industriale, duke përfshirë ndërtimin e një muri ndarës mes deponisë dhe lumit për ta parandaluar bartjen e materialeve mbetje dhe të rrjedhjes së tyre në lum.
- ii) Mbulimi dhe mbajtja nën kontroll e zonës (afërsisht një hapësirë prej ~80 Ha) në bazë të përvojave më të mira ndërkombëtare dhe mbulimi me vegjetacion i zonës. Vendosja sipër e një shtrese të trashë të dheut prej 40cm mbi mbetjet e deponuara industriale.

Prioriteti i intervenimit: Shumë i lartë

Buxheti: Buxheti i përgjithshëm për zbatimin e punimeve në deponinë e Zitkovacit vlerësohet në 2 300 000 euro, ndërsa përmirësimi i deponisë në Gornje Polje vlerësohet të jetë **4 500 000 euro**, që në total është **6 800 000 euro**.

Studimet e bëra:

1. Environmental geochemistry of soils of the Kosovska Mitrovica region (Northern Kosovo), Università di Siena Dipartimento di Scienze Ambientali Sezione di Geochimica Ambientale, 2004
2. Environmental Management in Kosovo: Heavy metal emissions from Trepca, 2003/2004

<p>6</p>	<p>FAZA E DYTË E RIKULTIVIMIT TË DEPONISË SË GRAÇANICËS</p> <p>Kjo deponi është shumë afër Graçanicës, dhe është burim i pluhurit në sezonet e thata. Po ashtu është afër lumit të Graçanicës, i cili mund ta destabilizojë materialin e deponuar përmes erozionit. Deri më tani, Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA) ka bërë një varg vlerësimesh mjedisore dhe ka kryer disa punë përmirësuese në këtë lokacion, duke përfshirë stabilizimin e deponisë, mbajtjen e saj nën kontroll dhe formësimin e pjerrëtinave dhe mbulimin e perimetrit me 30 cm të dheut. Megjithatë, nevojiten masa shtesë për rehabilitim për ta shmangur rrezikun.</p> <p>Intervenimet e nevojshme</p> <p>Përgatitja e dizajnit përfundimtar për rehabilitimin + zbatimin e punimeve në zonën e deponisë së Kelmendit, që përfshinë si në vijim:</p> <p>i) Mbulimi dhe mbajtja nën kontroll e zonës, duke përfshirë rikultivimin.</p> <p>Prioriteti i intervenimit: I lartë</p> <p>Buxheti: Buxheti i përgjithshëm për këtë intervenim është vlerësuar të jetë 300 000 euro.</p> <p>Studimet e bëra:</p> <p>1. Rydergren A., and Montelius M. (2004), Environmental Remediation at Paddock Tailings Area, Gracanica, Kosovo, SIDA Evaluations, SIDA.</p>
<p>7</p>	<p>MBULIMI I DEPONISË T2 NË LOKACIONIN MINERAR TË ARTANËS</p> <p>Lokacioni minerar i Artanës ndodhet në pjesën lindore të Kosovës, dhe është pjesë integrale e Ndërmarrjes Trepça. Ky lokacion minerar është identifikuar si pika më e nxehtë dhe më komplekse mjedisore në rajon për dy arsye: i) mbetja industriale përmban koncentrik të lartë të metaleve të rënda të deponuara në afërsi të ujërave; dhe ii) materiet acidike që dalin nga miniera (përmbajnë koncentrik të lartë të metaleve të rënda) shkarkohen drejtpërdrejtë në lumin Kriva Reka pa ndonjë trajtim paraprak. Lumi Kriva Reka ndikon drejtpërdrejtë në ujin e pijshëm të ujërave që vijnë nga qyteti i Kamenicës (një qytet me 13 000 – 15 000 banorë). Dy deponitë u rehabilituan nga qeveria e Holandës, të mbështetura financiarisht dhe të zbatuara nga UNDP-ja (2007-2010). Megjithatë, ende nevojiten masa shtesë përmirësuese për t'i mbajtur nën kontroll deponitë si dhe mbulimin e deponisë më të madhe (T2).</p> <p>Intervenimet e nevojshme</p> <p>Përgatitja e dizajnit përfundimtar për rehabilitimin + zbatimin e punimeve:</p> <p>i) Spërkatja e mbetjeve industriale me tretës gjelqeror dhe mbulimi i mbetjeve industriale me shtresë të freskët të dheut – trashësia 40 cm, duke përfshirë edhe mbjelljen e barit (vetëm për deponinë T2).</p> <p>Prioriteti i intervenimit: I mesëm</p> <p>Buxheti: Buxheti i përgjithshëm për këtë aktivitet është vlerësuar të jetë 450 000 euro.</p> <p>Studimet e bëra:</p> <p>1. MONTEC (2007), Final Report: Environmental assessment and Remedial Action Plan (EARAP): Stan Trg/Stari Trg and Artana/Novo Brdo Mines, Kosovo, UNDP Kosovo, Environmental Assessment and Remedial Action Plan (EARAP): Stanterg/Stari Trg and Artana/Novo Brdo Mines Project.</p>

III. REHABILITIMI I TOKËS BUJQËSORE

7	<p>REHABILITIMI I TOKËS BUJQËSORE DHE HAPËSIRAVE PUBLIKE NË MITROVICË</p> <p>Emetimet atmosferike nga impiantet metalurgjike përbëjnë burimin kryesor të ndotjes së dheut prej metaleve të rënda, përmes pjesëzave që barten përmes ajrit si dhe të ndotësve në formë gazi që dalin gjatë përpunimit të xehes si pasojë e erës dhe bartjes përmes ujit nga deponitë e pambrojtura. Dheu sipërfaqësor paraqet mbajtësin kryesor të metaleve të rënda, dhe se zonat bujqësore në zonat urbane dhe periferike u ekspozohen në veçanti mbajtjes së ndotësve në sasi të madhe. Në varësi prej aftësisë së specieve për thithjen e metaleve të rënda, bimët që rriten në tokë me koncentrik të lartë të metaleve të rënda akumulojnë ndotës në forma të ndryshme në pjesën e tyre që është për t'u ngrënë. Duke hyrë në zinxhirin ushqimor të njeriut përmes të mbjellave ose përmes rrjedhjes së ujërave tokësore, këta ndotës pastaj mund të akumulohen në koncentruet helmues, të cilët mund ta rrezikojnë seriozisht shëndetin e njeriut. 'ndërmarrja minerale i Trepçës' në Kosovën veriore, pikërisht në shkretoren e Pb-Zn të Zveçanit dhe në Parkun Industrial të Mitrovicës) kanë shkaktuar kontaminim afatgjatë dhe serioz të mjedisit përreth, duke përfshirë një zonë më të gjerë me fillim prej Vushtrrisë e deri në Leposaviq.</p> <p>Intervenimet e nevojshme Intervenimet e nevojshme si pjesë e këtij aktiviteti janë:</p> <p>i) Bërja e kërkimeve për shpërndarjen hapësinore të metaleve të rënda në dhe, duke përfshirë analizimin e faktorëve bio-akumulativ dhe absorbimi i metaleve të rënda nga të mbjellat e ndryshme, perimet dhe pemët, thithja e tyre nga njeriu përmes zinxhirit ushqimor. Në fund, hulumtimi do të shtjellojë efektet në shëndetin e njeriut dhe masat për t'iu shmangur marrjes së metaleve të rënda. Hulumtimi do ta mbulojë zonën e komunave të Vushtrrisë, Zveçanit dhe Leposaviqit. Përveç kësaj, hulumtimi do të rekomandojë masa dhe mënyrën se si të rehabilitohet sipërfaqja e kontaminuar (hapësirat e banimit dhe toka bujqësore).</p> <p>ii) Rehabilitimi i zonave të banuara dhe tokës bujqësore. Ashtu siç është theksuar nga hulumtuesit e ndryshëm se tokat e punueshme në rajonin e Mitrovicës përhapin helme të metaleve të rënda në ushqimin bazë. Rehabilitimi i hapësirave publike të banuara dhe të tokës bujqësore për heqjen e shtresës së sipërme të dheut dhe zëvendësimin e tij me dhe të freskët të pakontaminuar është një mënyrë për parandalimin e marrjes së metaleve të rënda nga njeriu.</p> <p>Prioriteti i intervenimit: Shumë i lartë</p> <p>Buxheti: Buxheti total për intervenim i) vlerësohet 400 000 – 450 000 euro, ndërsa për intervenimin ii) vlerësohet të jetë 7 000 000 – 8 500 000 euro.</p> <p>Studimet e bëra:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Ministero Dell'ambiente E Della Tutela Del Territorio, and Università Di Siena (2005), Final Report: Environmental Geochemistry of Soils of the Kosovska Mitrovica Region (Northern Kosovo) and Mapping of Soil Pollution of Mitrovica Region for Different Metals.2. Dorothy Sanders (2010), Urban and peri-urban agriculture as a way for human uptake of heavy metal pollutants, Trepca Mine Complex, Mitrovica, Kosovo.
---	---

IV. FUSHATAT E VETËDIJESIMIT

7	<p>Krahas zbatimit të punimeve rehabilituese me synim të zvogëlimit të rrezikut të drejtpërdrejtë nga mbetjet industriale, si një veprim mbështetës për punimet dhe aktivitetet e mësipërme, është planifikuar të zhvillohet një fushatë për ngritjen e vetëdijes së publikut ku do të theksohen ndikimet negative në shëndetin e njeriut dhe në mjedis për shkak të aktiviteteve minerare në të kaluarën, si dhe të veprimeve që mund të ndërmerren nga bashkësia për zvogëlimin e efekteve në shëndetin e tyre dhe angazhimin e tyre në procesin e vendimmarrjes.</p> <p>Aktivitetet për ngritjen e vetëdijes duhet të dizajnohen në atë mënyrë që të jenë gjithëpërfshirëse, ku do të merrnin pjesë publiku i përgjithshëm, pushteti lokal dhe të tjerët, industria, mjekët si dhe të gjitha nivelet e arsimit, të cilët do të përgjigjeshin ndaj këtij problemi në mënyrë të harmonizuar. Fushata e vetëdijesimit do ta përfshijë medien (të folur dhe të shkruar të vendit) në promovimin e mbrojtjes së mjedisit dhe të sjelljes miqësore ndaj tij, organizimin e debateve publike dhe në diskutimin e mënyrave të shëndetshme të jetesës, etj.</p> <p>Prioriteti i intervenimit: Shumë i lartë</p> <p>Buxheti: Buxheti i përgjithshëm i fushatës së ngritjes së vetëdijesimit vlerësohet të jetë 500 000 euro.</p>
---	---

- Plani i veprimit duhet të përfshijë një strategji për komunikim me donatorët, ose duke u takuar me ta në mënyrë individuale ose duke organizuar ndonjë tryezë të rrumbullakët.
- Intervenimet e propozuara duhet të përfshihen në Planin e veprimit mjedisor të Kosovës 2011-2015 për qëllim të ngritjes së fondeve

ANEKSI 1 – AGJENDA

Konferenca për menaxhimin e mbetjeve industriale të Ndërmarrjes Trepça

E hënë, 19 shtator 2011.

Vendi: Mitrovicë, Restorant KRAPI

Dita 1

9:00	Regjistrimi i pjesëmarrësve
9:30	Mirëseardhje pjesëmarrësve Z. Dardan Gashi, Ministër – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Znj. Osnat Lubrani, Koordinatore e UN dhe përfaqësuese rezidente e UNDP-së Z. Besim Beqaj, Ministër – Ministria e Zhvillimit Ekonomik Z. Ferid Agani, Ministër – Ministria e Shëndetësisë Z. Avni Kastrati, Kryetar i komunës së Mitrovicës Z. Ferat Shala, Drejtor menaxhues e Ndërmarrjat Trepça
Tema 1: Gjendja e mjedisit në rajonin e Mitrovicës	
10:00	Dokumentar për Ndërmarrjan Trepça dhe gjendja aktuale e Trepçës Z. Ferat Shala, Drejtor menaxhues i Ndërmarrjat Trepça
10:20	Një vështrim i përgjithshëm i gjendjes aktuale të deponive të Trepçës dhe ndikimi në mjedis Z. Ali Ahmeti, Drejtor i Departamentit për zhvillim dhe mbrojtje të mjedisit
10:30	Strategjia minerare e Kosovës dhe politikat mjedisore Z. Kemajl Zeqiri, Ministria e Zhvillimit Ekonomik (Departamenti për strategji)
10:45	Cilësia e mjedisit në rajonin e Mitrovicës për shkak të eksploatimit në shkallë të gjerë të mineraleve nga impiantet e Trepçës Z. Luan Shllaku, Drejtor ekzekutiv i KFOS
11:05	Gjendja e mjedisit në pikat e nxehta Z. Ilir Morina, Shef i Agjencisë për Mbrojtje të Mjedisit – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
11:25	Deponitë e Trepçës dhe minierat e saj – problemet mjedisore – një vështrim i përgjithshëm për zgjidhje Dr. Habil Frank Riesbeck, Universiteti Humboldt në Berlin, Departamenti i Ekologjisë dhe Shfrytëzimit të Rezervateve
11:25–11:45	Pushim për kafe
11:45	Përmirësimi i pikave të nxehta – përvoja çeke (miratimi i legjislativitetit, shembuj të përmirësimit në republikën çeke) dhe gjendja e mjedisit në Parkun Industrial të Mitrovicës Z. Jiri Kubricht, Menaxher i projektit në kompaninë Dekonta

12:05	Pyetje dhe debat (burimet kryesore të kontaminimit; deponitë dhe ndikimi në mjedis, kontaminimi i ujit, ajrit dhe tokës në zonat urbane që ndodhen afër deponive)
13:25 – 14:40	Pushimi i drekës
Tema 2: (E kaluara dhe e tashmja) Veprimtaria minerare/metalurgjike e Trepçës dhe ndikimi në shëndetin e njerëzve	
14:40	Ndikimi i kontaminimit të mjedisit me plumb në shëndetin e njeriut në rajonin e Mitrovicës Dr. Dorit Nitzan, OBSH
15:00	Bujqësia urbane dhe periferike si mënyrë për absorbimin e ndotësve të metaleve të rënda nga njeriu Znj. Dorothy Sanders, BSc. Universiteti i Durhamit
15:20	Rreziqet që përsëriten në deponi (shembulli i Hungarisë), mënyrat kryesore të kontaminimit, masat e nevojshme për zvogëlimin e rrezikut Znj. Christina Stuhlberger – Z. Pier Carlo Sandei, UNEP
15:35 – 16:20	Pyetje dhe debat (veprimtaria minerare dhe shëndeti i njeriut, ekzaminimi dhe ofrimi i kujdesit shëndetësor në Kosovë për pacientët e identifikuar me nivel të lartë të metaleve të rënda në gjak, bujqësia si mënyrë për absorbimin e metaleve të rënda)
16:20 – 16:30	Pushim për kafe
Tema 3: Strategjitë e zvogëlimit – praktikat më të mira ndërkombëtare për përmirësim dhe zhvillim ekonomik	
16:30	Dokumentar i shkurtër dhe veprimtaritë përmirësuese në 8 pika të nxehta në Ballkanin Perëndimor Z. Stewart Williams, Këshilltar teknik i UNDP – UNEP
17:05	Iniciativat e ENVSEC në lidhje me menaxhimin e mbetjeve industriale Z. Laura Rio, ENVSEC / UNEP Vjenë
18:00	Vizitë në muzeun e mineraleve të Trepçës në Stantërg

9:15	Mirëseardhje për pjesëmarrësit Moderatori
09:30	Koncepti i përmirësimit të deponive në Evropën juglindore, shembuj nga Kosova, Mali i Zi dhe Rumania Z. Nikolaus Linder, nga Fichtner Mining & Environment GmbH (FME)
09:45	Lista e prioriteteve në fushën e rikultivimit të lokacioneve të kontaminuara dhe menaxhimi i mbetjeve industriale të Ndërmarrjes minerar të Ndërmarrjes minerare të Trepçës Dr. Habil Frank Riesbeck, Universiteti Humboldt në Berlin, Departamenti i Ekologjisë dhe Shfrytëzimit të Rezervateve
10:10	Rehabilitimi i mbejeteve minerare dhe metalurgjike: praktikat e mira për rehabilitim Z. Pier Carlo Sandei - UNEP
10:30	Prezantimi i projekt-propozimeve për ndërmarrjen e masave përmirësuese afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata Znj. Nezakete Hakaj, Shefe e Divizionit për Mbrojtje të Mjedisit, MMPH
10:50 – 11:05	Pushim për kafe
11:05 – 12:05	Pyetje dhe debat (degradimi i mjedisit dhe shëndeti i njeriut, praktikat më të mira ndërkombëtare për përmirësimin dhe lidhjet me zhvillimin ekonomik; cilat janë strategjitë për pakësimin dhe mbrojtjen e menjëherëshme të degradimit të mëtejshëm të mjedisit)
12:05 – 12:45	Përmbledhje e shkurtër për rezultatet e konferencës dhe veprimet pasuese Z. Dardan Gashi, Ministër – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (të konfirmohet) Z. Besim Beqaj, Ministër i Zhvillimit Ekonomik
12:45	Përmbyllje Z. Avni Kastrati – Kryetar i komunës së Mitrovicës Z. Ferat Shala, Drejtor menaxhues i Ndërmarrjat Trepça
13:00	Dreka

ANEKSI 2 – LISTA E PJESËMARRËSVE

Organizata	Emri	Pozita
Qeveria e Kosovës	Bujar Bukoshi	Zëvendëskryeministër i Kosovës
MMPH	Ilir Mirena	Zëvendësministër i MMPH
MMPH	Nezakete Hakaj	Shefe e divizionit për mbrojtje të mjedisit
MMPH	Gazmend Avdiu	Këshilltar për komunikim me median
MMPH	Ilir Morina	Kryeshef i AMMK
MMPH	Naim Alidema	Zyrtar
MZHE	Gani Koci	Zëvendësministër i MZHE
MZHE	Besim Veselaj	
MZHE	Kemajl Zeqiri	Shef i strategjisë minerare
MZHE	Nehat Rrahimi	Zyrtar
MZHE	Skender Sallahi	Shef divizioni
MZHE	Ferit Maliqi	Shef sektori
MZHE	Adnan Preniqi	Shef sektori
MZHE	Dukagjin Shala	Shef divizioni
Komuna e Mitrovicës	Rizah Haziri	Nënkryetar
Komuna e Mitrovicës	Gani Rrustemi	Drejtor i drejtorisë
Komuna e Mitrovicës	Xheklal Shabani	Drejtor i drejtorisë
Komuna e Mitrovicës	Agron Sulejmani	Inspektor
Komuna e Mitrovicës	Irfan Peci	Zyrtar
UNDP	Osnat Lubrani	Koordinator i UN dhe përfaqësues reziden- cial (RR) i UNDP
UNDP	Steliana Nedera	DRR
UNDP	Abedin Azizi	Analist programesh
UNDP	Nora Sahatciu	
UNDP	Armend Muji	Shef i komunikimit
UNDP	Burbuqe Dobranja	Zyrtar i komunikimit
UNDP	Arbnora Gojani- Mazreku	Asistente e RR/DRR
UNDP	Steëart Ëilliams	Këshilltar kryesor teknik
UNOPS	Afrim Cejku	Zyrtar i programit
OBSH	Skender Sylja	Shef i misionit
OBSH	Dorit Nitzan	
UNICEF	Agron gashi	
IKSHP	Nysret Ymeri	
UNFPA	Doina Bologna	CTA
Ambasada austriake – Oda austriake eko- nomike	Vjosa Huruglica	

UN-Habitat	Krystina Galezia	CTA
UN-Habitat	Fadil Dalipi	Planifikues hapësinor
UN-Habitat	Drita Nushi	Planifikues hapësinor
UNEP	Pier Carlo Sandei	Zyrtar për programe
ENVSEC	Laura Rio	Koordinator i programit
RDA	Fatos Raifi	Drejtor ekzekutiv
JICA	Yumi Yasuda	Koordinator
JICA	Arberore Riza	
EC	Gazmend Selimi	
Komisioni parlamentar për mjedisin	Nait Hasani	Kryesues i komisionit
Komisioni parlamentar për mjedisin	Sevdije Lama	
Komisioni parlamentar për mjedisin	Nijazi Idrizi	
FXM	Izet Zeqiri	Rektor
FXM	Shyqeri Kelmendi	Ligjërues
FXM	Alush Musaj	Prorektor
OEK në Mitrovicë	Rrustem Abiti	
Ambasada gjermane	Matias Kiesler	Zëvendësshef i misionit
Ambasada britaneze	Jan Cliff	Ambasador
Ambasada britaneze	Nemanja Jovanovic	
ACC në Prishtinë	Shkelzen Beqiri	Krye-shef
Universiteti i Humboldt-it në Berlin	Frank Riesbeck	Ligjërues
Miniera Fichtner	Nikolaus Linder	Gjeolog
Kompania Dekonta	Jiri Kubricht	Menaxher i projektit
Universiteti Durham	Dorothy Sanders	/
Ambasada finlandeze	Vesa Kotilainen	
Nder	Ferat Shala	Drejtor menaxhues
ndërmarrja Trepça	Ali Ahmeti	Drejtor i departamentit për mbrojtje të mjedisit
ndërmarrja Trepça	Halil Qela	Zëvendës-menaxher
ndërmarrja Trepça	Besmir Sadiku	Specialit i TI
ndërmarrja Trepça	Myftar Hyseni	Shef i divizionit
ndërmarrja Trepça	Beqir Maliqi	Drejtor
ndërmarrja Trepça	Bislim Muqa	
ndërmarrja Trepça	Milaim Sadiku	
ndërmarrja Trepça	Bajram Mustafa	
ndërmarrja Trepça	Selim Frangu	Drejtor i minierës në Artanë
OJQ Eko Trepça	Ramadan S. Uka	Drejtor
OJQ Eko Trepça	Eshref Misini	Anëtar
REC	Zeqir Veselaj	Drejtor - Kosovë
REC	Avdullah Nishori	Koordinator
ICMM	Ibush Januzi	
ICMM	Azem Rexhaj	Drejtor

OJQ IADK	Zenel Bunjaku	Drejtor
Poseidon Group	Bekim Kastrati	Ekspert minierash
Poseidon Group	Matheë Hurley	Krye-shef
Poseidon Group	Burim Thaqi	HD
Poseidon Group	Dominic Roserb	COO
Moser Group – PORR austriak	Senad Ramaj	